



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. 5302/3 prot

Tiranë më 24/12/2018

VENDIM

Nr. 35 Datë. 4/12/2018

PËR

MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE NGA HEC MALI SUBJEKTIT "TIRANA ENERGJI" SH.P.K

Në zbatim të të të ligjit nr 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", përkatësisht të nenit 42 pika 3; Neni 50, pika 2, N.52 gërma c; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore" si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015 ndryshuar me VKM nr. 718 datë 12.10.2016", " Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", nenit 24, gërma "f", ndryshuar me Vkm 718 datë 12.10.2016" me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit "TIRANA ENERGJI " SH.P.K. Keshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

V E N D O S I:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit "TIRANA ENERGJI" SH.P.K. me administrator **Z.Eris XHEMALI**, për përdorim të burimit ujor duke shfrytëzuar **ujrat e ujëmbledhësit të Bovillës të lumit të Tërkuzës, në tubacionet ekzistuese dhe tubacionet e reja që përcjellin ujërat e lumit të Tërkuzës nga ujëmbledhësi i Bovillës deri në impiantin e trajtimit Bovillë**, për prodhim energjie elektrike, në fshatin Zall-Her, Bovillë, Qarku Tiranë. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti për **HEC MALI** do të ketë këto të dhëna:
Koordinatat e veprës së marrjes sistemi GAUSS KRUGER:

X – 44 05 572 Y –45 90 853; Z- 290

Koordinatat e veprës së marrjes sistemi KRGJSH:

X – 48900.516 Y –4590111.932; Z- 290

Prurja mesatare: Q mes 1.560 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q₃₅₅= 0.080 m³/sek;

Saisa që do jepet në përdorim: $Q_{\text{lllog}} = 1.8 \text{ m}^3/\text{sek.}$

Prurja që shkarkohet $Q_{\text{lllog}} = 1.8 \text{ m}^3/\text{sek.}$

Fuqia e instaluar $E = 740 \text{ KW}$

Numri i orëve që do të shfrytëzohet – 3741 orë ne vit.

2- Autorizimi përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, duke respektuar marrëveshjen e UKT sha nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3. Mos të çënojë burimet e Bovillës së vjetër dhënë më leje përdorimi Ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizime Kamëz nga Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen.

4- Ngarkohet A.B.U Ishëm –Erzen për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUANI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

